

**KARTELE INFORMATIVE**

**AL021048**

<b>1. Emri i shërbimit</b>	Zëvendësimi i plastmasës në serra
<b>2. Cili është qëllimi i shërbimit?</b>	Mbështetje financiare për fermerët aplikues në sektorët që mbështeten nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural (Udhëzimi nr. 3, datë 24.02.2020 i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, i ndryshuar) me qëllim: a) rritjen e konkurrueshmërisë së prodhimeve blegtorale, të prodhimeve bujqësore në mjediset e mbrojtura dhe uljen e kostove të prodhimit, nëpërmjet pagesave të kafshëve të matrikuara e subvencionimit të çmimit të plastmasës; b) shtimin e sipërfaqeve të mbjella me bimë mjekësore dhe aromatike; c) certifikimin e produkteve bujqësore dhe fermave organike; ç) mbështetjen e diversifikimit të aktiviteteve ekonomike në zonat rurale.
<b>3. Çfarë ofron ky shërbim?</b>	Zëvendësimi i plastmasës termike për serrat diellore ekzistuese për prodhimin e perimeve, rrushit për tavolinë dhe tunelet plastike për prodhimin e luleshtrydhes në vlerën respektive 300 000 (treqind mijë) lekë/hektar dhe 100 000 (njëqind mijë) lekë/hektar, por jo më shumë se 500 000 (pesëqind mijë) lekë për subjekt. Sipërfaqja e serrës apo e tunelit plastik të jetë jo më pak se 0.2 (zero pikë dy) hektar. Përfitues janë subjektet, të cilët nuk mund të mbështeten nga programi IPARD II.
<b>4. A jam përfitues?</b>	1. Fermer individual; 2. Person fizik ose juridik.

Nr	Lloji	Dokumenti lëshohet nga:	Dorëzohet në sportel nga aplikanti?
1	Letërnjoftimi elektronik / Pasaportë biometrike	Zyra e gjendjes civile	Po
2	NIPT (Numri i Identifikimit të Personit të Tatueshëm) / NUIS (Numri Unik i Identifikimit të Subjektit) i fermerit	Drejtoria Rajonale e Tatimeve	Po
3	Vërtetim për numrin e llogarisë bankare	Banka të nivelit të dytë	Po
4	Vërtetim për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shlyerje të detyrimeve tatimore	Drejtoria Rajonale e Tatimeve	Po
5	Planvendosjen e serës/tunelit plastik me të dhënat kryesore, për të cilën kërkohet të zëvendësohet plastmasa, sipas aneksit nr. 3 të Udhëzimit nr. 3, datë 24.02.2020 i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (i ndryshuar)	Aplikanti	Po
6	Dokumentacioni i pronësisë së tokës apo marrjes me qira: Pronësia mbi tokën bujqësore, vërtetohet me një nga dokumentet e mëposhtëm: 1. Certifikatë pronësie, e shoqëruar me hartën treguese dhe kartelën e pasurisë së paluajtshme; 2. Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP), sipas legjislacionit për ndarjen e tokës bujqësore, bashkëlidhur me fragmentin e hartës kadastrale, të vërtetuar nga Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT) ose Njësia Administrative ku ndodhet ngastra. Në të dy rastet, kur aplikuesi është një nga anëtarët e familjes bujqësore dhe pronësia i takon familjes bujqësore, është e nevojshme dakordësia para noterit e bashkëpronarëve të familjes	Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi, hartat treguese merren në Drejtorinë e Administrimit të Mbrojtjes së Tokës ose Njësia Administrative. Certifikata e pronësisë/HTR (harta treguese) dhe kartela e pasurisë merren në Drejtorinë Rajonale të Kadastrës	Po

**5. Çfarë dokumentesh duhen për aplikim?**

	7	<p>1. Fatura/faturat tatimore të blerjes së plastmasës, të shoqëruar me certifikatën e garancisë;</p> <p>2. Akt zhdoganimin për rastet kur plastmasa vjen nga jashtë vendit e shoqëruar me certifikatën e garancisë.</p> <p>Faturat e mësipërme duhet të jenë të shoqëruara me kuponin e kasës fiskale ose mandatpagesën e bankës</p>	Subjekte tregtare të fushës	Po
	8	Vërtetim që aplikanti nuk është debitor ndaj Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural	Jo
<p><b>Zyrat pritëse</b> Online në portalin e-Albania; AGROPIKA, Zyra bujqësie.</p>	<p><b>Qyteti</b> Online në portalin e-Albania; Berat, Kuçovë, Çorovodë, Dibër, Bulqizë, Mat, Durrës, Krujë (Fushë-Krujë), Elbasan, Gramsh, Peqin, Librazhd, Fier, Mallakastër, Lushnje, Gjirokastrë, Përmet, Tepelenë, Korçë, Devoll, Pogradec, Kolonjë, Kukës, Has, Tropojë, Lezhë, Kurbin, Mirditë, Shkodër, Malësi e Madhe, Pukë, Tiranë, Kavajë, Sarandë, Delvinë, Vlorë.</p>	<p><b>Adresa</b> Online në portalin e-Albania; 1. AGROPIKA Berat - lagjja 30 Vjetori, rruga "Koli Vesho", pranë Dr. Policisë Q. Berat, afër shkollës 1 Maji. 2. Zyra e Bujqësisë Kuçovë - rruga "5 Qershori", lagjja Tafil Skendo, Qendër Kuçovë, ngjitur me kishën Katolike. 3. Zyra e Bujqësisë Çorovodë - rruga "Arkitekt Kasemi", pranë kantinës së pijeve Naço. 4. AGROPIKA Dibër - lagjja Dobrovë, në hyrje të Peshkopisë, godina e parë majtas. 5. Zyra e Bujqësisë Bulqizë - Qyteti i Ri, Bulqizë. 6. AGROPIKA Mat - qendër Burrel, e njëjta godinë me Bashkinë Mat. 7. AGROPIKA Durrës - ish-komuna Rrashbull, brenda Qendrës Administrative. 8. Zyra e Bujqësisë Fushë-</p>	<p><b>Orari</b> Online: 24 orë; Gjatë periudhës së aplikimit sportelet AGROPIKAVE, do të qëndrojnë të hapura, e hënë - e premte, nga ora 08:00 deri në 16:30</p>	

**6. Ku mund të aplikoj?**

*Krujë - ish-SMT Fushë Krujë.*

*9. AGROPIKA Elbasan - kryqëzimi i Cërrikut.*

*10. Zyra e Bujqësisë Gramsh - lagjia Xhile Lici, pranë pallateve private.*

*11. Zyra e Bujqësisë Peqin - lagjia Teqe, rruga "Kalla", nr. 50.*

*12. AGROPIKA Librazhd - Stacioni i Trenit.*

*13. AGROPIKA Fier - rruga "Jani Bakali", lagjia 1 maji, pranë kishës Katolike.*

*14. Zyra e Bujqësisë Mallakastër - bulevardi "Rrapo Hekali", lagjia 5 Shkurti, përballë Muzeut Historik Mallakastër.*

*15. AGROPIKA Lushnje - lagjia Çlirimi, rruga "Bulevardi i Palmave", pranë QTTB (pranë varreza të dëshmorëve). 16.*

*AGROPIKA Gjirokastrë - rruga kryesore "Gjirokastrë-Sarandë", lagjia Punëtore, pranë Postbllokut.*

*17. AGROPIKA Përmet - lagjia Mejtem, (në periferi të Përmetit, pranë Gurit të Qytetit).*

*18. Zyra e Bujqësisë Tepelenë - lagjia 15 Shtatori (përballë gjimnazit).*

*19. AGROPIKA Korçë - rruga e Voskopojes, pranë AKU.*

*20. Zyra e Bujqësisë Devoll - rruga e Bilishtit, përballë karburant Kastrati.*





*21. AGROPIKA Pogradec - lagjia 1, rruga e Korçës, përballë karburantit Gora.*

*22. Zyra e Bujqësisë Kolonjë - në hyrje të Ersekës, ish-qendra e grumbullit (NGP).*

*23. AGROPIKA Kukës - rruga "Kukës-Morinë", kilometri 1.*

*24. Zyra e Bujqësisë Has - rruga "Luan Hajredini", lagjia e Gecja.*

*25. Zyra e Bujqësisë Tropojë - rruga "Fatmir Hasandoci", lagjia*

			<p>Gjongecaj, pranë ish-hotel turizmit.</p> <p>26. AGROPIKA Lezhë - bulevardi Gjergj Fishta.</p> <p>27. Zyra e Bujqësisë Kurbin - lagjja nr. 2, pranë Zyrës së Punës.</p> <p>28. Zyra e Bujqësisë Mirditë - sheshi kryesor, ngjitur me godinën e Bashkisë.</p> <p>29. AGROPIKA Shkodër - rruga "Lidhja e Prizrenit", lagjja Manush Alimani, . 30. Zyra e Bujqësisë Malësi e Madhe - rruga e Komisarariatit, lagjja Mehaj, Koplík.</p> <p>31. AGROPIKA Pukë - rruga "Halil Qel Tërbuni", brenda institucionit të tatim-taksave Pukë.</p> <p>32. AGROPIKA Tiranë - rruga "Siri Kodra", pranë kryqëzimit me unazën e Tiranës, (afër ish-punishtes së pastrave).</p> <p>33. AGROPIKA Kavajë - rruga e Mandarinave, lagjja nr. 4, sipër stacionit të trenit Kavajë.</p> <p>34. AGROPIKA Sarandë - rruga "Studenti", pranë filialit Universitar Sarandë.</p> <p>35. Zyra e Bujqësisë Delvinë - rruga "Nazif Haderi", pranë bashkisë Delvinë.</p> <p>36. AGROPIKA Vlorë - rruga "Transballkanike", pranë ish ZVRPP-së.</p>	
7. A është ky shërbim online?	<p><b>Niveli 1</b></p> <p>Ofrohet informacion mbi shërbimin</p> 	<p><b>Niveli 2</b></p> <p>Ofrohet informacion dhe mundësi shkarkimi i formularit të aplikimit</p> 	<p><b>Niveli 3</b></p> <p>Ofrohet informacion dhe mundësi për dorëzimin e aplikimit online</p> 	<p><b>Niveli 4</b></p> <p>Shërbimi ofrohet tërësisht online</p> 
8. Sa është tarifa për marrjen e shërbimit?	<p><b>Tarifa bazë</b></p> <p>Shërbim pa pagesë</p>	<p><b>Tarifa shtesë</b></p>	<p><b>Tarifa Online</b></p>	<p><b>Mënyra e pagesës</b></p>
9. Sa kohë nevojitet për të marrë shërbimin?	<p>Me përfundimin e aplikimeve dhe kontrollit administrativ të dokumenteve që gjenerohen online, Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural shpall brenda 10 ditëve pune listën e aplikimeve të kualifikuara me vizën e financimit dhe dokumentet e kërkuara sipas masës përkatëse, në faqen zyrtare të saj <a href="http://www.azhbr.gov.al">www.azhbr.gov.al</a> si dhe listën e printuar në të gjitha pikat e pranimit të aplikimeve.</p>			
10. Çfarë përfitoj?	<p>Aplikanti merr informacion nëpërmjet faqes zyrtare <a href="http://www.azhbr.gov.al">www.azhbr.gov.al</a> për renditjen e aplikimit sipas masës bashkë me vijën e financimit, brenda 10 ditë pune pas përfundimit të fazës së pranimit të aplikimeve bashkë me dokumentet që duhet të dorëzojë sipas afateve të përshkruara në udhëzimin.</p>			

11. Ç'afat vlefshmërie ka?	<p>Aplikanti pas përfshirjes në vijën e financimit, duhet të plotësojë dokumentet sipas kritereve dhe afateve të përcaktuara në udhëzim dhe gjithashtu duke u konsultuar me faqen zyrtare <a href="http://www.azhbr.gov.al">www.azhbr.gov.al</a> për të dorëzuar dokumentacion e plotë. Mos dorëzimi i dokumenteve në afatin sipas listave të shpallura në faqen web të Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, është kriter s kualifikimi.</p>			
12. Ku e marr?	Në sportele <input type="checkbox"/>	Me postë <input type="checkbox"/>	E-albania <input checked="" type="checkbox"/>	Me e-mail <input type="checkbox"/>
13. Cili është institucioni përgjegjës?	Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR)			
14. Ku mund të gjej informacion për këtë shërbim?	<b>Kontaktto në:</b> E- albania: <a href="http://e-albania.al">e-albania.al</a> ADISA web: <a href="http://www.adisa.gov.al">www.adisa.gov.al</a> ADISA email: <a href="mailto:Informacion@adisa.gov.al">Informacion@adisa.gov.al</a> AZHBR web: <a href="http://azhbr.gov.al/">http://azhbr.gov.al/</a> Qendra e Informimit mbi Shërbimet Publike: 0800 0118	<b>Orari</b>  Qendra e Informimit mbi Shërbimet Publike: E hënë - e premte, ora 08:00 - 19:00		
15. Nëse kam ankesë, si të veproj?	Në sportele <input type="checkbox"/>	Me postë <input checked="" type="checkbox"/>	Web-i i Institucionit <input type="checkbox"/>	Me e-mail <input checked="" type="checkbox"/>
16. Cila është baza ligjore e këtij shërbimi?	Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 100, datë 05.02.2020 "Për përcaktimin e kritereve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë e zhvillimin rural, për vitin 2020"; Udhëzimi nr. 3, datë 24.02.2020 i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural "Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural" i ndryshuar.			